

V E N D I M
Nr.560 datë 16.10.1995

**PËR MASAT PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7699, DATË 21.4.1993 “PËR KOMPENSIMIN
NË VLERË TË ISH-PRONARËVE TË TOKËS BUJQËSORE”.**

Në zbatim të ligjit nr.7699, datë 21.4.1993 “Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore” siç është ndryshuar me ligjin nr.7981, datë 27.7.1995, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve dhe komisionet e kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve në rrethe, që janë ngritur me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.301, datë 14.6.1993, do të kryejnë funksionet sipas këtij vendimi edhe për zbatimin e ligjit nr.7699, datë 21.4.1993 “Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore” me ndryshimet përkatëse.

2. Në funksion të punës së komisioneve të kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve në rrethe për zbatimin e ligjit, pranë seksionit të kadastrës së çdo rrethi, do të punojnë me shkëputje nga puna edhe dy specialistë, nga të cilët një agronom dhe një topograf. Pagesa e tyre do të bëhet nga fondet që mbulojnë veprimëtarinë e komisioneve, duke gëzuar edhe të drejtën e shtesës mbi pagë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.301, datë 14.6.1993, ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.402, datë 1.8.1994.

Personave të sipërm u ruhet vendi i punës për gjithë periudhën deri në përfundim të veprimëtarisë së tyre.

3. Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve, në zbatim të ligjit “Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore” ka këto të drejta dhe detyra:

a) Evidencon pretendimet e ish-pronarëve për probleme që nuk kanë gjetur zgjidhje në këtë ligj.

b) Bën mbledhjen jo më rrallë se një herë në muaj, shqyrtonë problemet e ngritura dhe hartonë e i propozon Këshillit të Ministrave akte të reja ose plotësime në aktet ekzistuese ligjore e nënligjore.

c) Bën drejtimin metodik të veprimëtarisë së komisioneve, ndjek procesin e kompensimit në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore dhe raportonë periodikisht në Këshillin e Ministrave për ecurinë e zbatimit të ligjit.

ç) Jep përgjigje dhe u bën sqarimet përkatëse personave të interesuar për problemet që përmban ligji.

d) Nxjerr udhëzime të veçanta që janë të detyrueshme për zbatim nga komisionet e kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve në rrethe.

Komiteti e zhvillon veprimëtarinë e tij pranë Këshillit të Ministrave.

4. Komisionet kanë këto detyra dhe të drejta:

a) Njohin të drejtën e pronësisë për ish-pronarët e tokës bujqësore, duke marrë vendimin përkatës të arsyetuar për njohjen dhe masën e kompensimit të saj.

b) Kontrollonë vërtetësinë e dokumentacionit që paraqesin kërkuesit dhe e ballafaqojnë me dokumentacionin teknik të zyrës së kadastrës për sasinë e sipërfaqes dhe masën e kompensimit që u takon.

c) Urdhërojnë organet financiare në rreth dhe bashki (përkatësisht sipas vendndodhjes së tokës) të ekzekutojnë detyrimet në përputhje me vendimin që ka marrë komisioni.

ç) Kërkojnë nga zyrat e kadastrës dhe ato të hipotekës që kanë në evidencë tokën bujqësore, të paraqesin dokumentet që komisioni i gjykon të nevojshme.

d) Në përputhje me ligjin dhe në bazë të dokumentacionit përkatës, përcaktojnë rastet kur ish-pronarët nuk përfitojnë kompensim në vlerë të tokës bujqësore.

dh) Evidençojnë pretendimet e kërkuesve që nuk kanë gjetur zgjidhje në këtë ligj dhe ia paraqesin ato Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve.

e) Komisionet e rretheve mbulojnë veprimëtarinë e kompensimit në vlerë të tokave bujqësore jashtë vijave kufizuese të qendrave të banuara në juridiksionin e këshillave të rretheve, ashtu edhe në juridiksionin e atyre bashkive që administrojnë tokë bujqësore, si dhe rastet e tokave ish-bujqësore që

kanë mbetur pa u kompensuar sipas ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”.

ë) Komisioni i dërgon periodikisht zyrës së gjendjes gjyqësore pranë Ministrisë së Drejtësisë, Gjykatës së Kasacionit dhe organeve të pushtetit lokal listën e personave që kanë praqitur deklarata për efekt të nenit 12 të ligjit. Nëse nga verifikimi do të vërtetohet e kundërta e asaj që është deklaruar, personit i hiqet e drejta e kompensimit dhe denoncohet për ndjekje penale.

f) Komisioni, pasi pranon kërkesën dhe dokumentet që paraqesin ish-pronarët, i administron ato dhe i regjistron në regjistrin e veçantë.

Kërkuesi, për çdo kërkesë të paraqitur komisionit, paguan një tarifë shërbimi në masën 2000 lekë, e cila do të përdoret për të mbuluar një pjesë të shpenzimeve që bëhen në këtë drejtim.

5. Ish-pronarët ose trashëgimëtarët e tyre ligjorë, që pretendojnë kompensim në vlerë të tokës bujqësore, në zbatim të nenit 14 të ligjit, duhet të paraqesin në komision deri në datën 31 mars 1996 krahas kërkesës me shkrim edhe këto dokumente:

a) Aktin e pronësisë nga kadastra ose hipoteka. Në mungesë të tyre vendimin e gjykatës për vërtetimin e pronësisë të marrë vetëm mbi bazën e kritereve të caktuara me këtë vendim.

b) Aktin e trashëgimisë.

c) Prokurën, kur vepron si përfaqësues i ish-pronarit ose trashëgimëtarëve të tij.

ç) Vendimin e dhënë nga komisioni për diferencën e pakompensuar të tokës bujqësore sipas ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”.d) Deklaratë personale për efekt të nenit 12 të ligjit.

e) Dokumentin që vërtetonë sasinë e tokës së përfutur në pronësi apo në përdorim sipas ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, ose nga aktet ligjore e nënligjore për shpërndarjen e pasurisë së ish-kooperativave bujqësore dhe NB-ve ose dokument negativ kur nuk kanë marrë tokë të lëshuar nga zyra e kadastrës së rrethit të vendbanimit për ish-pronarin ose secilin trashëgimëtar ligjor të tij.

Sasia e tokës që ka përfutur trashëgimëtari në këtë rast do të zbritet në përllogaritjet e sipërfaqes së tokës bujqësore që do t’i kompensohet në pjesën takuese.

dh) Trashëgimëtari, krahas dokumenteve të mësipërme, duhet t’i paraqesë komisionit edhe një certifikatë, nga e cila do të përcaktohet vendbanimi i sotëm i tij.

6. Ata pretendues, të cilëve u janë dhënë toka sipas ligjit të vitit 1932 “Për vendosjen e emigrantëve” dhe ligjit të vitit 1935 “Për reformën agrare”, do të trajtohen si ish-pronarë në zbatim të këtij ligji për të gjitha procedurat.

7. Në rastet kur zyra e hipotekës ose ajo e kadastrës nuk disponon të dhëna për të lëshuar vërtetim zyrtar të pronësisë sipas regjistrave përpara reformës agrare (për ato zona ku është zbatuar kjo reformë), vërtetimi i pronësisë do të bëhet sipas kësaj procedure:

a) Kryepleqësia e fshatit, e kërkesës së të interesuarit, lëshon vërtetim zyrtar për sipërfaqen e ish-pronës, ish-pronarin e saj dhe emrat e ish-pronarëve kufizues.

b) Vërtetimi i kryepleqësisë së fshatit i kalon për verifikim e saktësim komisionit të verifikimit të pronësisë në komunën përkatëse i cili përbëhet nga:

- Sekretari i këshillit të komunës - kryetar.

- Agronomi i drejtorisë së bujqësisë dhe ushqimit të rrethit, që punon pranë asaj komune - anëtar.

- Topografi, që punon pranë asaj komune - anëtar.

c) Vendimi i këshillit të komunës që merret mbi bazën e vërtetimit të komisionit të verifikimit të pronësisë në komunë, i dërgohet zyrës së kadastrës ku, pasi të përpunohet nga specialistët e cituar në pikën 2 të këtij vendimi, i kalohet për të vendosur përgjegjësit të kadastrës. Përgjegjësi i kadastrës i lëshon sipas rastit vërtetim pozitiv ose negativ pretenduesit, të shoqëruar me një kopje të vendimit të këshillit të komunës.

Këto dokumente do të jenë të vlefshme si provë shkresore për vërtetimin e pronësisë, me vendim të gjykatës së rrethit përkatës.

Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit të nxjerrë udhëzimin e nevojshëm për formën dhe përmbajtjen e formulimit të vërtetimit zyrtar të kryepleqësisë së fshatit, të vendimit të këshillit të komunës për vërtetimin e pronësisë dhe të vërtetimit të përgjegjësit të zyrës së kadastrës në rreth, si dhe për afatet kohore procedurale nga paraqitja e kërkesës prej ish-pronarëve pretendues deri në marrjen e vërtetimit nga kadastra.

8. Drejtoria e bujqësisë dhe ushqimit e çdo rrethi t’i japë zyrtarisht komisioneve të kthimit

dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve në rrethe listën e tokave bujqësore të kategorizuara në klasa për çdo fshat sipas ligjit nr.7836, datë 22.6.1994 “Për çmimin e tokës bujqësore për efekt kompensimi” me ndryshimet përkatëse.

9. Për efekt të zbatimit të paragrafit të dytë të nenit 6 të ndryshuar të ligjit, ish-pronarit apo trashëgimëtarëve të tij ligjorë, nga sipërfaqja e tokës ish-pronë që i është dhënë në përdorim, komisioni ka të drejtë që t’i kalojë në pronësi aq sa ka marrë, por jo më shumë se sa i takonte të merrte sipas normës përkatëse ligjore.

10. Në zbatim të nenit 14/c të ligjit, degët e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit në rrethe njohin të drejtën e parablerjes së ish-pronarit ose trashëgimëtarëve të tij për objektet e ndërtuara nga shteti mbi sipërfaqen e tokës bujqësore ish-pronë e tij, kur të privatizohen me çmimet e përcaktuara sipas dispozitave në fuqi.

Kur në një objekt që shitet, vërtetohet se ka disa pronësi mbi tokën, atëherë të gjithë ish-pronarët e kësaj toke kanë të drejtën e parablerjes, në raport me pjesët takuese të pronësisë.

11. Vendimi që merret nga komisioni hartohet në tri kopje, nga të cilat njëra mbetet në dosje dhe administrohet me regjistër të veçantë.

Vendimi i komisionit është i detyrueshëm për zbatim nga organet financiare, sipas përcaktimeve që do të bëjë Ministria e Financave.

12. Në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit të krijohet një grup pune për të supervizuar punën në rrethe nga zyrat e kadastrës dhe drejtoritë e bujqësisë dhe ushqimit, në zbatim të këtij vendimi.

13. Për zbatimin e këtij vendimi, nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave për vitin 1995, këshillave të rretheve u shtohet një fond prej 2 milionë lekësh.

Për vitin 1996, Ministria e Financave të parashikojë në buxhet pagat dhe shpërblimet për specialistët shtesë sipas këtij vendimi.

14. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministria e Financave, Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve, komisionet e kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve në rrethe si dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe degët e saj në rrethe.

15. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.499, datë 17.10.1994, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi